

INTERVISTË ME ALBERTINA AJETI-BINAKU

Prishtinë | Data: 6 prill, 2018

Kohëzgjatja: 54 minuta

Të pranishëm:

1. Albertina Ajeti-Binaku (E intervistuar)
2. Jeta Rexha (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Jeta Rexha: A mundeni me u prezentu t’lutem, me përshkru pak vetën në fjalë të shkurta?

Albertina Ajeti-Binaku: Okej, unë jom Albertina Ajeti-Binaku. Jom 47 vjeçare, jom nanë e tre fëmijëve. Përndryshe, jom drejtoreshë e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Maqedoni-Kosovë. Shkurtimisht kjo është sa m’përket meje.

Jeta Rexha: Tash t’lutna me m’tregu çka mbanë n’mend prej protestave t’marsit, të vitit ‘89, prej ‘80 deri ‘89?

Albertina Ajeti-Binaku: N’atë kohë veç ka qenë, filloi ajo periudha, po flas vitet e ‘80-ta. Prej një fëmijërie t’mirë të them, prej një hapësire që ne e kemi pasë n’atë kohë si fëmijë e pastaj n’shkollë të mesme. Duke u ndërlidhë me situatën e cila veç, në ish-Jugosllavi, filloi të ndërlikohej, gjithsesi se pat ndikim edhe në Kosovë. Edhe me të tregu të drejtën e mbaj n’mend diku në vitin e katërt të shkollës së mesme, kur minatorët veç u patën mbyllë në, në Mitrovicë në atë kohë... E mbaj n’mend se ishim në vitin e katërt t’shkollës t’mesme edhe studentët protestonin domethonë si përkrahje ndaj minatorëve. E ne të vitit t’katërt nuk na lejshin me hy aty se nuk ishim studenta. Edhe çmos bojshim për me hy në sallën “25 maj”, [sot] “1 tetori”, domethonë n’atë kohë që ka qenë.

Çka mbaj n’mend, mbaj n’mend gjithsesi se filloi situata domethonë me u keqësu. Lëvizja jonë nuk ishte ashtu e lirë si ishte ma herët. Në shkollë u vërejke disponim jo i mirë i mësimdhënësve, po gjithashtu edhe në shtëpi. Pasi që nënën e kom pasë mësuse, është në pension, babin e kom pasë profesor. Edhe në atë kohë t’gjithë prindërit kanë qenë LDK. Edhe sa do, ku do krejt ajo situatë ndikojke edhe jashtë shtëpisë edhe mrenda shtëpisë.

Mirëpo... kjo filloi prej ‘81. Me ju tregu t’drejtën e mbaj n’mend edhe ‘81-shin. Kam qenë ndoshta, saktësisht nuk po m’kujtohet vetëm e di se shtëpinë e kemi pasur në Dragodan... edhe mbaj n’mend që studentët që ikën prej qytetit patën ardhë në atë pjesën e Dragodanit, tash veç Arbëria. Edhe m’kujtohet gazin lotësjellës që e kanë pasë n’atë kohë në Prishtinë. Edhe i mbaj n’mend fytyrat e studentëve në atë kohë, edhe pse kom qenë fëmijë. Ato maskat edhe mënyra se si ikshin, sidomos prej qendrës të Prishtinës.

E mandej prindërit tanë u mundojshin për me ju gjetë rrugën që me ikë, sepse mbrapa Dragodanit osht’ një pjesë që osht’ si një mal i vogël. Edhe u mundojshin t’gjithë me ju gjetë edhe... Domethonë

nëpër garazha, nëpër bodrume që me ikë. Sepse forcat policore në atë kohë vetëm dojshin me i arrestu. Domethonë edhe pse e vogël e mbaj n'mend që veç prej '81-shit... Mandej edhe në vitet në vazhdimësi, gjithmonë... fëmijëria dhe rinia jonë osht' përcjellë me protesta, me lajme t'kqija, me...

E mbaj n'mend stadiumin në Prishtinë, sepse prej shtëpisë t'prindërve të mi shifej stadiumi, edhe ka qenë përplotë me tanke, me policë, me... në atë kohë të policisë së ish-Jugosllavisë. Edhe e mbaj n'mend një detal, sepse na ndalshin në rrugë, sidomos e mbaj n'mend një detal me babin. "Letërnjoftimin"... Na ndalën, isha me babin edhe po ia kërkojnë letërnjoftimin. Ai po merr me krejt dorën me marrë letërnjoftimin, ai po thotë, në gjuhën serbe, "Jo, jo. Vetëm me dy gishta". Se u frigojshin. Domethonë ka shumë detaje t'cilat i mbaj n'mend.

E ironia e gjithë kësaj, po kthehem prapë te ajo në vitin '89, në protestat me 1 tetor. Ka qenë sepse në atë kohë, une po flas për vetëvete, nuk e kena pa rrezikun që po na, osht', osht' ka vjen. E kemi pa atë protestë si një mënyrë për me hy në një rreth të njerëzve ma t'pjekun, n'atë kohë të studentave edhe profesorave. Mirëpo, si të ri në atë kohë nuk e kemi vlerësu edhe nuk e kemi pa rrezikun. Ka qenë kohë kur e kërkojshin dorëheqjen e Kaqusha Jasharit, Rrahman Morinës. E di që patëm dalë n'rrugë tu protestu që mos me i hekë... domethonë...

Jeta Rexha: Qysh osht' folë mes juve krejt qekjo që ka ndodhë? A osht' pa e natyrshme, a osht' pa diçka që mundet me...

Albertina Ajeti-Binaku: Jo...

Jeta Rexha: Që po bjen diçka ma t'madhe?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, me të tregu të drejtën, për atë edhe e potencova ma herët... sepse kur i ndigjojshin prindërit tanë me me miqt që bisedojshin, ndoshta për shkak të eksperiencës dhe për shkak të moshës rezonojshin në një mënyrë tjetër, edhe e vlerësojshin situatën në një mënyrë tjetër. Ndërsa ne, jo. Ka qenë ashtu diçka që e kemi pa si një ngjarje që do të ndodhë dy-tri ditë dhe do të kthehemi në një stabilitet. Do ti rikthehmi jetës që kemi pasë. Po flas për gjeneratën time, për shokët e mi, shoqet e mia, nuk e kemi pa ashtu.

Deri sa në mbramje kur i ndëgjojshim bisedat, prindërit tanë tu e ndëgju radio Europën në atë kohë, në radio. Domethonë ka qenë pasqyrë tjetër t'cilën ata e kanë pa, mirëpo na nuk e kemi përceptu në atë mënyrë. Domethonë që kemi bisedu diçka rreth asaj, kemi bisedu, por me të tregu të drejtën, prapë po thom ndoshta kemi qenë ma të ri edhe nuk kemi mendu në atë mënyrë. Sepse jemi rritë në atë frymën e bashkim vllazërimit, kemi udhëtu t'libër, kemi udhëtu në ish-Jugosllavi në atë kohë, në Kroaci, në Beograd, në Vojvdinë, në Slloveni... Domethonë, kemi qenë t'libër edhe nuk kemi qenë të edukum me urrejtë njoni-tjetrin. Edhe për ne ka qenë e, e...

Jeta Rexha: A ka qenë shumë zhgënjyse?

Albertina Ajeti-Binaku: Gjithsesi... E pa imagjinueshme që do të vie, qo do të vijnë gjanat më vonë ashtu edhe si u zhvilluan. Domethonë nuk kemi, nuk kemi ditë me urrejtë njoni-tjetrin. Domethonë në

atë kohë kemi shku në ekskurzion bashkë, kemi qenë në shkolla bashkë. Kemi mësu gjuhën serbe, ata kanë mësu gjuhën shqipe, jemi shoqnu, kemi dalë. Domethonë, nuk ka pasë urrejtje ndërmjet të rive dhe fëmijëve në atë kohë. Prandaj edhe po e them që ka qenë e paimagjinushme që gjërat do të zhvillohen në mënyrën qysh jonë zhvillu.

Jeta Rexha: Okej. Tash me u fokusu ma shumë te protesta me bukë, marshit në Drenicë. Qysh, tash nëse e mban n'mend krejt atë ditë, prej fillimit deri n'fund, qysh ka qenë procesi? Prej momentit që je çu prej gjumit e ke ditë që ki me shku n'marsh?

Abertina Ajeti-Binaku: Qajo protestë në të cilën, lidhet gjithsesi me vdekjen e babit. Babi jem ka qenë profesor edhe në atë kohë domethonë ka qenë një ndër udhëheqësit kryesor të LDK-së. Edhe në atë kohë patëm fillu me i bo certifikatat, vulat e republikës të Kosovës. Edhe në atë kohë babi im ka qenë i burgosur disa herë. Edhe në të '97-tën ka vdekë prej infraktit, domethonë 51 vjeçar.

Edhe protesta, pjesëmarrja ime në atë protestë ka qenë diçka që osht' ndërlihdë definitivisht me vdekjen e babit. Në atë kohë nuk kemi pasë, ka qenë RTP-ja në atë kohë, mirëpo informatat kanë qenë të cungume. Nuk kemi pasë na qasje. Mirëpo, prapë se prapë gjërat të cilat ndodhnin në terren, në vende si Drenicë, në atë kohë... sidomos në Drenicë. Ishin atëhere gazeta ditore "Koha Ditore", e vetmja që ka qenë. Edhe ajo gazetë ka qenë informatori kryesor edhe po menoq shqiptarët, ne në Kosovë informatat i kemi marrë prej asaj gazete në atë kohë. Ajo gazetë ka qenë më revolucionare në atë kohë. Ndoshta ata aty mrenda kanë pasë probleme, mirëpo informatat jonë dalë, edhe prej atyhit i kemi marrë informatat.

Domethonë sipas RTP-së në atë kohë, edhe sipas shtypit ditor është marrë vesh që në atë kohë në Drenicë jonë rretheku familjet. Nuk kanë ushqim, nuk kanë qasje, fëmijët nuk kanë pasë ushqim. Edhe si nanë, në atë kohë i kom pasë dy fëmijë, Trinën edhe Gentin.... Mirëpo, në atë kohë s'kemi pasë internet si tash edhe...

Jeta Rexha: Qysh e keni përcjellë informatën?

Albertina Ajeti-Binaku: E vetmja, i vetmi komunikim ka qenë në mëngjes kur e kemi, kur kemi dalë domethonë me i çu fëmijët në shkolla, në çerdhe, që jemi taku, kemi bisedu, kemi pi kafe. Atëhere krejt, domethonë ka qenë një mobilizim i përgjithëm në atë kohë i krejt popullsisë në Kosovë. Edhe gjatë muhabetit, "O osht' një protestë nesër, për këtë arsye, për këtë arsye..." Edhe osht' vendosë që të protestohet në mënyrë paqësore, të mirrët një bukë në dorë edhe me atë bukë të nisemi për Drenicë, me qëllim që atë bukë të ja u dorëzojmë familjeve të cilat kanë qenë të rrethekuara nga forcat serbe në atë kohë.

Edhe kjo ka qenë domethonë në atë kohë iniciativë e kolegeve, shoqeve, nanave të cilat i kemi pasë fëmijët bashkë në çerdhe edhe në shkollë. Mirëpo, domethonë informatat jonë marrë gjithësi edhe prej televizionit lokal atëhere RTP-së, por edhe prej "Kohës Ditore".

Jeta Rexha: A t’kujtohet konteksti qysh osht’ plasur qajo informatë, çka osht’ thonë edhe krahasimi prej asaj që publikisht osht’ ditë edhe prej asaj që ka ndodhë realisht atë ditë?

Albertina Ajeti-Binaku: Po, po, nuk... Në atë kohë me të tregu t’drejtën gjatë bisedës, detajet, nuk ka qenë tendenca me i jap konotacion politik. Ka qenë më tepër për me jap konotacion humanitar, sepse familjet me ditë t’tana, me javë t’tana ka qenë të rrethekuara. Nuk kanë pasë lëvizje t’lirë, domethonë me dalë më u furnizu me ushqim e me gjana tjera. Edhe kjo ka qenë. Domethonë ne, si nana, si femra, me bashkëndje me nanat në atë kohë në Drenicë, të cilat nuk kanë pasë ushqim për fëmijët e tyre.

Edhe në anën tjetër ndoshta me apelu pak te autoritet e atëhershme që me leju ndihmat humanitare, ushqimi, veshëmbathjet, çkado që kanë pasë nevojë, me, me, me ju jap mundësia që ndihmat me pasë... me hy në fshatna edhe me pasë qasje për ata që kanë pasë nevojë. Domethonë ka qenë vetëm çështje humanitare, ndihmë humanitare dhe ndoshta me prekë në vetëdijen e autoritetit të atëhershëm që jemi nana edhe arsya e vetme osht’ që t’ju ndihmojmë nanave në Drenicë në atë kohë. Sepse kjo ka qenë specifikisht për regjionin e Drenicës.

Jeta Rexha: Tash me i’u kthy bukës. Qysh e keni marrë bukën, a keni marrë prej shpisë t’juj, a osht’ shpërnda kur keni mrrri në pikë takim? Edhe ku ka qenë pikë takimi, ma herët gjatë ditës, me konë ke shku?

Albertina Ajeti-Binaku: Jeta, vendtakimi me të tregu të drejtën nuk më kujtohet. E di që bukën e kemi marrë vet. Ka pasë edhe që kanë shpërnda aty. Edhe e di që kemi hecë prej qendrës, saktësisht tash s’po m’kujtohet. Mirëpo, kemi vazhdu deri te, atëhere ka qenë “Show Restaurani”, tash osht’ UN-i, ku osht’ “Jysku” tash, qe qaty, edhe na kanë kthy. Edhe pjesëmarrja ka qenë e madhe, ka pasë shumë gra. Dhe e mbaj n’mend që në rend t’parë kanë qenë domethonë n’atë kohë.... Kemi majtë bukën naltë ashtu si n’shenjë proteste, domethonë lejuni, kanë nevojë për ushqim fëmijët, nanat, familjet.

Edhe e di që kemi qenë si, domethonë ka qenë si kolonë edhe anash kanë qenë forcat policore. Deri sa kemi mrrri në atë pikë, mandej nuk na kanë leju me shku ma tutje. Kanë kërku me negociu, mirëpo nuk kanë qenë të gatshëm. Ashtu në mënyrë, me fjali urdhërore na kanë thanë, “Duheni mu kthy, përndryshe nuk mujmë me rreziku sepse mandej mundet me ju ndodh diçka, s’mujmë me ju mbrojtë...” Mirëpo, nuk na kanë lanë më shku. Domethonë deri te ajo pjesa, tash ku osht’, ku jonë ato qendrat tregtare në rrugë për Fushë Kosovë. Aty na kanë ndalë, edhe na kanë kthy.

Jeta Rexha: A ka qenë dikush që ka vazhdu tutje?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo.

Jeta Rexha: A ka provu dikush me vazhdu tutje?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, Jeta, jo se ka pasë forca të mëdha policore. Nuk kemi... edhe mandej të them të drejtën në atë kohë gratë të cilat jonë marrë me oragnizime të tilla, e di që jonë konsultu edhe mandej bashkarisht kemi vendosë për me u kthy në Prishtinë. Po e di që ka qenë një ditë e zymtë, e ftoftë, me shi. Edhe që gra ka pasë shumë, po edhe forca policore ka pasë shumë.

Jeta Rexha: A ka pasë, qysh ka qenë demografia e grave, a ka pasë gra t'reja, t'vjetra, ma t'moshume? A ka pasë burra? A ka pasë fëmijë?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo burra nuk ka pasë. Une sa, sa e mbaj n'mend burra nuk ka pasë. Edhe osht', iniciativa kur na osht', kur kemi diskutu edhe na osht' spjegu... domethonë, prapë po kthehem, sepse me pas pasë burra nuk e kishte mrrri atë efektin që dojshim na me mrrri në atë kohë. Domethonë që na jemi nana, na jemi femra, nuk kemi t'bëjmë më politikë, osht' çështje humanitare. Po kanë qenë vajza t'reja, kanë qenë ma t'moshume. Domethonë demografia ka qenë e ndryshme. Mirëpo, mashkuj nuk ka pasë, krejt femna,

Jeta Rexha: A ka pasë gra që kanë qenë, po ma merr mendja në Forumin e grusë të LDK-së, a kanë iniciu ato, a kanë qenë zë ma aktiv kur osht' dhanë informata e marshit, ose kur osht' folë për marshin, qysh osht'...

Albertina Ajeti-Binaku: E mbaj n'mend në rendin e parë edhe t'dytë kanë qenë gratë të cilat kanë qenë domethonë pjesë e LDK-së. Edhe kur kemi mbërri te, domethonë ajo pjesa ku ka qenë policia. Forcat policore, ato e di që kemi tentu, kemi pritë muj me thonë gjysë ore, 45 minuta që me na lëshu me vazhdu ma tutje. E mbaj n'mend që ato kanë negociu. Mirëpo, nuk na kanë leju për me vazhdu ma tutje.

Jeta Rexha: Domethonë, qajo negociatë osht' bo, osht' bo n'paqe, n'qetësi...

Albertina Ajeti-Binaku: Po, në qetësi, nuk.... Me të tregu të drejtën ata na kanë përcjellë gjatë tërë kohës, mirëpo deri në një masë, domethonë në një pjesë t'rrugës, mandej nuk na kanë lanë me shku ma tutje. Nuk na kanë lanë më vazhdu.

Jeta Rexha: Qysh...

Albertina Ajeti-Binaku: Na thanë, "Kthehuni, sepse nuk mund të ju sigurojmë që s'do t'ju ndodhë diçka. Osht' luftë, osht'... kanë ndodhë disa gjana..." Për t'cilat neve nuk na tregunë çka ka ndodhë, mirëpo ata nuk na lejunë me shku ma tutje. Edhe tha, "Në qoftë se vazhdoni, shkoni në përgjegjësi të ju. Mirëpo, ne nuk mund t'ju sigurojmë..." Domethonë që do të vazhdohet deri atje ashtu qysh e kishim paramendu na.

Jeta Rexha: Edhe kjo ju osht' bo me dije prej ushtrisë serbe?

Albertina Ajeti-Binaku: Po, po. Ushtri nuk ka pasë, unë sa e mbaj n'mend ka pasë polic. Shume polic. Ushtri nuk mbaj n'mend që ka pasë.

Jeta Rexha: A ka qenë kjo ma shumë si sygjërim që tash osht' përgjegjësi e juja me vazhdu apo ka qenë farë lloj kërcënimi që nëse vazhdoni ka me pasë pasoja?

Albertina Ajeti-Binaku: Definitivisht ka qenë kërcënim. Nuk osht', nuk kemi pa një, domethonë një mirëkuptim prej anës t'tyne. Ka qenë definitivisht kërcënim edhe qasja e tyre, mënyra se si jonë

shprehë, si kanë bisedu, po menoj me përfaqësueset edhe organizatorët e protestës, nuk ka qenë pozitive. Edhe me, me insistu na që me vazhdu më tutje. Ka qenë kohë, kohë pa kohë ka qenë.

Jeta Rexha: Edhe jeni kthy qashtu t'organizumë qysh keni qenë?

Albertina Ajeti-Binaku: Po, jemi kthy...

Jeta Rexha: Në të njejtën rrugë?

Albertina Ajeti-Binaku: Po, të njejtën rrugë jemi kthy, mandej jemi shpërnda. Edhe osht' apelu që m'u shpërnda, mos me nejtë grupe-grupe se mudemi edhe me u burgos edhe me u malltretu edhe... Kështu që, na osht' sygjeru prej, doemthanë prej t'gjithë atyne që t'shpërndahemi nëpër shpija, t'mos... se ka qenë idea t'rrijmë mandej pak n'qytet e grupacione t'krijomë. Por, jo. Na u tha që me shpresën që e kemi mrii qëllimin me u shpërnda edhe e di që t'gjithë mandej jem shpërnda.

Jeta Rexha: S'ka pasë, nuk osht' bo e ditun që ka nejtë dikush, ose osht' burgosë dikush?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, jo. Sa e di une jo. Ajo mandej në media osht' paraqitë edhe osht' parë në një mënyrë ndoshta qëllimin të cilin e patëm në atë kohë... S'kemi mujtë me iu ndihmu familjeve definitivisht. Mirëpo, ka qenë prapë ndoshta një trokitje në vetëdijën e... edhe të qeverisë, të autoriteteve në atë kohë edhe të institucioneve ndërkombëtare t'cila kanë qenë në atë kohë për respektimin e të drejtave të njeriut. Kështu që... mandej, e di që mas kësaj proteste me insistimin e disa organizatave t'cilat kanë qenë n'atë kohë, ndërkombëtare po flas, e mbaj n'mend m'doket që CRS ka qenë, patën leju mandej me shpërnda ndihma e ushqim, mbas negociatave që i kanë pasë ata. Që po shpresoj krejt kjo, t'them protesta paqësore ka ndiku ndoshta në trokitjen e vetëdijes t'njerëzve të cilët osht' deshtë të ju ndihmojnë atyre njerëzve atje.

Pjesa e Dytë

Jeta Rexha: Ma tutje nuk ke pa ndonjë hap ma, naj rast kështu, naj shembull që e din që një familje, një komunitet veç e kanë, e ka marrë qat ndihmë që osht' sygjeru me ju dhonë?

Albertina Ajeti-Binaku: Atëhere Jeta nuk kem pasë na...

Jeta Rexha: Edhe mas disa viteve?

Albertina Ajeti-Binaku: Po, mandej mas luftës për shkak t'natyrës të punës time, po. Por, po mendoj qat kohë në vitin '98, domethonë ndoshta vetëm njerëzit që kanë qenë t'punësum në organizatat ndërkombëtare n'atë kohë. Edhe pse me të tregu të drejtën shumica pre tyne kanë hezitu n'atë kohë me bisedu për këto gjana, domethonë që ju kanë ndihmu, ju kanë dërgu ushqim, e barëra, e veshëmbathje. Mirëpo, domethonë unë jom mëse e bindne që protesta e ka arritë qëllimin e vet.

Jeta Rexha: Tash me t'pytë, tregove për kontekstin që ka qenë marshi atëhere, po me na tregu ndoshta pak, e përmende që edhe nëse kishin, që qajo pjesëmarrja e madhe e grave ka mrri deri dikun te efekti edhe rezultatin që keni dashtë. Po tash a mundesh me m'tregu në krahasim mes grupacioneve, takimeve ose protestave gjithëpopullore me ato të grave, ose tamam të asaj dite që veç gratë jonë mledhë? A din, qysh ka qenë konteksti që osht' folë, edhe mos ka qenë ndoshta ma, mos osht' propozu me qenë ma alusive kur osht' folë për një protestë gjithë popullore? A din, mos kanë qenë kërkesat ma t'mdhaja edhe ma specifike?

Albertina Ajeti-Binaku: Gjatë viteve, po flas për '89 deri '99, ka qenë kohë e protestave. Osht' e pamundur tash, më ktheve mrapa... edhe pjesëmarrja në protesta ka qenë, në krahasim me këtë t'grave, ka pasë. Mirëpo, protesat kur jonë ba, domethonë gjithë popullore, ka qenë domethonë tërë sheshi tash që osht' përplotë. Mandej e mbaj n'mend nuk na lejshin n'shesh me organizu. Jo une qe kom organizu, po kom dalë gjithë.

Mandej shkojshim në shkallët e "Dragodanit". Domethonë tash kur t'mendoj po thom kemi pasë një vullnet, një dëshirë ndoshta për një jetë ma t'mirë edhe për një jetë ma t'qetë edhe ma... edhe ajo dëshirë edhe ai vullnet na ka shty që me protestu edhe me dalë. Osht' e pamundur, a din me përshkru atë pjesëmarrjen në këto protesta... Te gratë, domethonë qëllimi i kësaj proteste ka dallu prej gjithëpopullore. Sepse kur kanë qenë gjithëpopullore kanë qenë kërkesat ma t'mëdha. Për gratë, në protestën të cilën une kom marrë pjesë ka qenë vetëm që si femër, si nanë bashkë më të gjithë aty të protestojmë për... edhe në një mënyrë t'i përkrahim nanat të cilat kanë qenë të ngujume n'atë kohë në fshatnat e Drenicës, që s'kanë pasë ushqim. Ka qenë dimër, mos t'harrojmë që ka qenë dimër. Edhe ka qenë shumë dimër i ftoftë edhe i gjatë.

Jeta Rexha: Po flet për vitin?

Albertina Ajeti-Binaku: '98. Edhe prapë po thom, domethonë kur ka qenë gjithëpopullore mendoj që kanë qenë kërkesat ma t'mëdha.

Jeta Rexha: A ka pasë naj faktor që osht', që ka qenë ma nxitës, me qujtë qashtu, ndoshta me qenë nacional ose qajo idea...

Albertina Ajeti-Binaku: Po... une nuk e kom...

Jeta Rexha: A osht' shfrytëzu edhe qaj faktor për protestën, e Marshit për Drenicë? Domethonë përpos me i ndihmu gratë të cilat ishin në nevojë, a osht' shfrytëzu edhe...

Albertina Ajeti-Binaku: Aspekti nacional. Po, po, definitivisht që po. Sepse na u pat zhvillu ajo ndjenja e patriotizmit, e ndjenjës që duhet me i ndihmu njeni-tjetrit, e ndjenjës që t'gjithë jemi n'rrezik jo veç ata, po t'gjithë jemi n'rrezik. E ndjenjës që dikush i cili ka jetu në vendet rurale ka nevojë për ndihmën e njerezvë të ciët jetojnë në vendet urbane. Tash kur e analizoj, gjithsesi po që ka qenë.

Jeta Rexha: Naj dallim, po kom qef me u kthy pak edhe qoftë '89-tën ose '81-tën nëse ke mbërri me dalë...

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, une në '81-tën jo se kam qenë...

Jeta Rexha: Ma e re...

Albertina Ajeti-Binaku: Po e mbaj n'mend, shumë mirë e mbaj n'mend.

Jeta Rexha: Qysh ka qenë '81-ta, mandej vazhdojmë? Ju keni jetu në "Dragodan"?

Abertina Ajeti-Binaku: Po në "Dragodan". Po t'thom qaq shumë ka pasë studenta, qaq shumë ka pasë njerëz, une e vogël kom qenë. S'po di tash në '81-tën, ndoshta kom qenë, domethonë i bjen... çka e mbaj n'mend? E mbaj n'mend e kemi pasë mrapa shtëpisë oborrit edhe krejt shtëpitë në "Dragodan" i kanë oborret mrapa. E mbaj n'mend që prej gazit lotësjiellësh edhe prej kërsimave, prej ballkonit t'shpisë Prishtina ka qenë kështu krejt tym ka qenë. Edhe tash ata murrën me ikë prej qendrës edhe "Dragodani" përpara, Prishtina s'ka qenë shumë e madhe, ka qenë e vogël. E mbaj n'mend që patën hy nëpër oborre të shtëpive, mirëpo edhe aty...

Jeta Rexha: I njëkshin...

Albertina Ajeti-Binaku: Po. Edhe e di që mandej kanë kalu nëpër dyrë, çdo shtëpi domethonë nëpër dyrë të garazhës edhe kanë ikë domethonë në atë pjesën e "Dragodanit", ku osht' një pjesë e malit. Filloi pastaj mu errësu, me ra, se ka qenë pranëverë. Fëmijë, po e mbaj n'mend. Edhe e mbaj n'mend që të nesërmen mandej, të nesërmen mandej nuk patëm shku në shkollë. Një kohë, disa ditë nuk patëm shku në shkollë. Edhe kur shkojshim në shkollë u frigojshim se s'dishim çka ka ndodhë. Po, po t'thom edhe ajo fotografia e stadiumit të Prishtinës përplotë me tanke, përplotë bre ka qenë... Auuu {onomatope}. Prej shpisë në Dragodan stadionin e shifshim mo krejt.

Mandej e mbaj n'mend iniciativën për me, n'mramje në ora tetë, qatëhere kur patën ndodhë me tepsia, me tenxhere, me lugë, me bo zhurëm n'ora tetë, tetë e pesëmbëdhjetë. Qashtu ka qenë për çdo natë.

Jeta Rexha: Sa ka zgjatë ajo?

Abertina Ajeti-Binaku: Khu Jeta, nuk m'kujtohet, e di që...

Jeta Rexha: Ka qenë disa ditë a?

Abertina Ajeti-Binaku: Po disa ditë me protestu domethonë...

Jeta Rexha: Qatë heshtjen.

Albertina Ajeti-Binaku: Po qatë heshtjen. Edhe mandej ushtojke qyteti. Ushtojke qyteti, domethonë me lugë, me tenxhere, me tepsia dilshim krejt edhe i ndalshim dritat e shtëpisë se vishin patrollat e policisë. Bile vishin me ato kamionetat që kanë qenë më ujë, me ato gomat e ujit. Edhe kalojshin nëpër "Dragodan". Bile për "Dragodan" sa e mbaj n'mend. Ama tonë ajo zhurmë në qytet. Se çdo familje i ndalshin dritat edhe bababa {onomatope}... e i krejt qyteti ashtu kërsima, zhurma t'enëve. Këto krejt kanë qenë ato paqësore deri sa mo veç eskaloj në diçka tjetër.

Jeta Rexha: E qatë ditë a ke mbajtur n'mend, a e keni çelë derën e shpisë me i thirrë studentët mrenda nëse kanë kalu nëpër oborrin e ju?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, Jeta. Mbaj n'mend prindërit që fillunë me ju japë ato si kërrpa, fillunë me ju shky, që me i qitë në gojë edhe në asi. Mandej ikshin në atë pjesë. Jo, se ata...

Jeta Rexha: S'kanë guxu...

Albertina Ajeti-Binaku: Jo që s'osht' guxu. Mendoj që edhe, po flas për prindërit e mi, gjithë atëhere ju ka pasë ardh befasi gjithë kjo ndodhi. Edhe prindërit e mi e mbaj n'mend që mandej me njëfarë hezitimi me njëfarë frike, po... mandej ujë me ju jap me i pastru durtë, sytë e këto, se mo prej gazit lotësjiellës. Po fëmijë kom qenë, e mbaj n'mend që prej ballkonit e kqyrsha, a din, i dëgjojsa kërsimat e... kanë qenë tash gazin lotësjiellës, tym në Prishtinë.

Kështu që e vetmja mënyrë, e di që n'atë kohë krejt komshitë aty që kemi qenë, ju kanë ndihmu me ujë edhe i'u kanë jap kërrpa me i mlu sytë edhe gojën, e hundën se shumë... Me ditë t'tana u ndi era e gazit lotësjiellës në Prishtinë. Edhe fakultet mandej, shkollat. Tanket nëpër qytet, policia...

Jeta Rexha: Në fund të '80-tave ka qenë edhe protesta tjetër për, ku gratë kanë protestu kundër vdekjes të ushtarëve [shqipëtar] të Ushtrisë Jugosllave (JNA)

Albertina Ajeti-Binaku: Po, po.

Jeta Rexha: A t'kujtohet, a ke qenë pjesë?

Albertina Ajeti-Binaku: Çka m'kujtohet prej asaj kohe? M'kujtohet se, domethonë vetëm n'television çka kemi pa. Po kanë qenë edhe lajmet, me siguri kanë qenë të reduktume të them ashtu, çka osht' qitë e çka jo në atë kohë. Çka mbaj n'mend n'atë kohë? E mbaj n'mend se disa prej djemëve të familjës kane qenë në ushtri. E mbaj n'mend që antarët e familjës u frigojshin. E di që shumica prej tyne, prej gjeneratës teme edhe ma herët, vetëm patën fillu me e lanë Kosovën edhe me ikë në diasporë, vetëm për mos me shku në ushtri, po.

E mbaj n'mend që frika ma e madhe ka qenë te, atë kohë, disa prej djemëve t'hallës, djemve t'dajës kanë qenë në ushtri. E di që zakonisht u frigojshin mos po ju ndodhë diçka, sepse u ndishin fjalët që jonë vra, jonë mbytë. Mirëpo, në atë kohë, prapë po kthehemi, mediat kanë qenë hala në frymën e "Bashkim-vllazërimin" e kumunizmit, socializmit. E mbaj n'mend që kur ka pasë ndodhë, tash s'po m'kujtohet qyteti, që i ka mbytë kinse ai shqiptari disa ushtarë edhe kanë thanë që jonë terrorista, që jonë.... Domethonë, nuk ka t'bëjë me pse jonë shqiptar, pse jonë vra. Osht' mundu m'u dhonë pasqyra që ata njerëz i kanë sulmu të tjerët në ushtri edhe për këtë arsye jonë vra.

Lajmet jonë dalë, jonë plasu në television edhe në gazeta. Mirëpo, jonë dhanë që, domethonë arsyeja pse jonë vra ose jonë ekzekutu ka qenë sepse jonë terrorista, jonë nacionalista shqiptar, i kanë vra dymbëdhjetë serb, tre kroat, katër boshnjak. Mandej veç filloi, domethonë fillunë kunfliktet në Slloveni, e në Kroaci, e mandej në Bosne e krejt. Po, domethonë në atë kohë, qatë moshë ajo bindja

jonë ka qenë që, sidoms gjeneratave më të reja, që ata njerëz që jonë vra edhe jonë mytë në ushtri të Jugosllavisë në atë kohë kanë qenë nacionalista, kanë dashtë këtë-atë. Mirëpo, mandej me kohë veç fillunë me dalë informata që nuk osht' e vërtetë. Po prapë, në atë kohë ka qenë definitivisht në vitet e '89-ta hala njëfarë terri informativ sa i përket këtyne gjanave.

Mandej veç në vitet e '90-ta ndryshoi situata pakëz. Në vitet e '80-ta jo. Hala ajo shpresa, po t'them, që situata, domethonë kemi me jetu prapë së bashku... ka qenë ndoshta, në një mënyrë njëfarë lloj naiviteti, sepse jemi rritë n'atë frymë, jemi eduku qashtu edhe...

Jeta Rexha: A u thy shumë, qai naiviteti që po thu, a u thy, a u shkatërru kur nisën, në fillimin e viteve të '90-ta?

Albertina Ajeti-Binaku: Filloi pas viteve të '90-ta, po. Në vit të tretë të fakultetit në arkitekturë neve na ka hy policia në fakultet edhe na ka qitë prej fakultetit. Po kjo pat fillu veç ma herët. Filloi me minatorët, mandej me suprimimin e autonomisë në atë kohë. E mandej universiteti, fillunë me i qitë njerëzit prej punës, me fillu me nënshkru domethonë. Prindërit e mi edhe prindërit e mij jonë pjesë e qatij grupacioni. Situata ekonomike veç u keqësu, sistemi shëndetësor u shkatërru. Mandej veç fillun, domethonë '92, '93, mandej veç veç ndasitë jonë vrejtë shumë.

Jonë vrejtë shumë, domethonë po flas për prindërit e mi. Prindërit e mij qaq shumë jonë shoqnu me kolegët e vet serb, edhe nana edhe babi, edhe kanë pasë shokë... Mirëpo, mandej ka ardhë koha edhe n'shkollë edhe n'fakultet edhe krejt, nuk kanë komunikuar fare. Krejt ka ndryshu, komplet. Osht' e pamundun, domethonë osht', osht' një reagim t'cilin duhet me studiu. Përnihere ashtu me, ajo 20 vjet, e 30 vjet që jemi, kemi kalu mirë, jemi shoqnu, kemi... Domethonë, thashë edhe n'ekskursion kemi shku bashkë. Edhe n'pushime prindërit e tonë kanë shku me kolegë. Domethonë ajo përnihere osht', osht' rrënu, osht' rrënu. Që unë menoj që osht' rrënu për lakminë e njerës anë sepse me largimin e punëtorëve të shqiptarëve n'atë kohë, mandej serbët kanë pasë beneficione t'mdhaja. Kanë hy në puna, i kanë pasë pagat e mëdhaja. Domethonë, une mendoj që ka qenë më tepër ajo përfitimi personal ekonomik, përveç atij nacional. Po mandej ajo, ai bashkëdysim edhe veç...

Jeta Rexha: Kur po flet për marrëdhënjet me, që i kanë pasë edhe prindërit tu me kolegët serb, po tash me u kthy, familjën e ju, kojshit ndoshta i keni pasë serb... Qysh kane qenë marrëdhëniet n'fillim t'protestave, prej '81-tës, '89-tës deri '98-tën? Kur kanë ndodhë protestat a ka pasë...

Albertina Ajeti-Binaku: Reagime prej tyne? Po, ka pasë.

Jeta Rexha: A ka pasë reagime prej tyne, po a ka pasë bashkëpunim me juve për me dalë n'protesta?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, jo, jo, jo...

Jeta Rexha: Qysh ka qenë domethonë qaj...

Albertina Ajeti Binku: Jo, jo...

Jeta Rexha: Qaj aspekt?

Albertina Ajeti-Binaku: Ata për çudi, po t'thom edhe... Jo. Ata përkundrazi, ata na kanë shiqu me urrejtje, me përçmim, me nënçmim, me... edhe gjatë protestave kanë dalë edhe jonë kërcënu, edhe... Domethonë osht' e, osht' shumë e çuditshme se si prej një marrëdhënie të mirë, veç kalon në diçka, në urrejtje, në nënçmim, në përçmim. Edhe për shembull ka pasë raste kur, për shembull për babin tim, kolegja më e ngushtë e babit që kanë qenë, që kanë punu bashkë, domethonë ajo veç... Për çdo herë që kanë pasë takime LDK-ja në atë kohë për çertifikata, diploma, shkollat që i kanë mbajtur nëpër shpia private, ajo vetëm e ka lajmëru në atë kohë policinë edhe ata jonë ardhë e kanë...

Domethonë, e pat kalu çdo kufi a din, osht', ka qenë... osht', ka qenë, u kriju njëfarë urrejtje që unë vështirë e kom me kuptu edhe tash. Prej asaj po jetojmë bashkë, po punojmë bashkë në një urrejtje patetike.

Jeta Rexha: A ka ndodhë mrenda nate? Qysh e ke ndi ti që osht' kirju qajo urrejtja, a osht' akumulë me kohë?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, jo. Nuk ka qenë brenda natës. Jo, nuk ka qenë brenda natës. Mendoj që ajo osht', osht' zhvillu me një plan. Një plan që paraprakisht osht' bo. Edhe çdo hap i cili osht' bo për me kriju qatë ndasi osht' realizu kështu në përpikëri. Por, jo, nuk ka ndodhë brenda natës. Muj me t'thonë që filloi veç me suprimimin e autonomisë në atë kohë. E mbaj n'mend kom qenë në fakultet në vitin e dytë. Përnjëherë në ora tre e pesëmbëdhjetë u ndalë radio, na qitën prej fakultetit. Domethonë edhe qaty mandej ka fillu. Shkollat, fakultetet, fabrikat, njerëzit. Edhe normal mandej ka qenë e përgaditne. Nuk osht' bo për një ditë. Tash kohën s'muj me, edhe nuk po du me paragjyku. Mirëpo, ka ndodhë në një afat jo të gjatë kohor, por sipas mendimit tim osht' diçka që osht' parapregaditë, osht' implementu me përpikëri.

Jeta Rexha: Okej, domethonë qaj konteksti shoqnor veç osht' ndërru edhe qeto kanë qenë rezultatet e qoftë protestave edhe nëse osht' bo ndonji kërkesë për bashkim, për çlirim, n'fund edhe prezencë juj, domethonë jeta juj e çdo ditëshme ka pasë efekt tjetër... Ose efekti osht' pru te jeta e juj që e keni jetu. Po tash këtu mujmë edhe me kalu se...

Albertina Ajeti-Binaku: Osht' efekti sepse une, tash bile, kur flas me fëmijët, edhe ju tregoj që na n'ora pesë jemi mbyllë në shtëpi, që ne s'kemi mujtë me dalë qysh ju tash dilni, që në vitin e katërt, n'atë kohë ka qenë me shku n'ekskursion në krejt Jugosllavinë, s'kemi guxu me shku. Në vitin e dytë n'fakultet ose t'tretë mos gabofsha, kemi pasë organizu në Shqipëri edhe në Greqi, arkitektura e vjetër, fillet e arkitekturës... nuk kemi mujtë me shku, s'na kanë leju profesorat. Domethonë, kemi qenë të okupum në çdo mënyrë.

E vetmja knaqësi ka qenë që n'mramje, domethonë edhe me i dëgju lajmet, me e dëgju radion çka po ndodhë. Domethonë, definitivisht gjeneratës tonë ju osht' cungru një pjesë e jetës, kështu. Ajo pjesa ma e mirë t'them e jetës. Se kemi qenë edhe n'fakultet shtëpi private, në vitin vitin e katërt e t'pestë, shtëpi private. E di prej motrës edhe vllaut në shtëpi private e kanë kry shkollën e mesme. Nuk kemi

pasë të drejtë, domethonë edhe me dalë Jeta, kemi pasë orë policore. Domethonë, ka qenë një kohë bajagi e shtirë, bajagi. Tash kur e krahasoj rininë e juv me tanën (qeshë) ka bajagi dallim (qeshë).

Jeta Rexha: Shkurtimisht me m'tregu për eksperiencën tande, unë e di që ke qenë n'fakultet të arkitekturës, mandej je transferu në shtëpi, në shtëpinë e dikujt?

Albertina Ajeti-Binaku: Po, në "Dragodan".

Jeta Rexha: Në "Dragodan". Edhe...

Albertina Ajeti-Binaku: Edhe kanë ardhë na kanë burgosë, profesorat i kanë rreh. Tash nuk m'kujtohet profesori i vizatimit t'libër e kemi pasë, kuku, nuk m'kujtohet emri, e pasna harru. Kanë hy në shtëpi, në "Dragodan" domethonë osht' zyrja amerikane një rrugë ma poshtë. Në njërin ka qenë fakulteti i arkitekturës, në shtëpinë tjetër ka qenë fakulteti i ndërtimitarisë. Qaty një përmbi një, 50 studenta, 60 studenta, kushtet minimale s'i kemi pasë. Ma e keqja që kemi pasë vizita tonë kohën prej policëve n'atë kohë edhe profesorat i merrshin.

Jeta Rexha: A jonë malltretu studentat, rruga tash prej shpisë deri shtëpi-shkollë, shkollë kur kanë shku faktikisht ose n'fakultet? Qysh e...

Albertina Ajeti-Binaku: E mbaj n'mend kemi pasë, se zakonisht në fakultet të arkitekturës kanë qenë afatet për me i dorëzu projektet. E mbaj n'mend në vitin e katërt, mos gabofsha, po në vitin e katërt kishim më dorëzu një projekt bajagi t'madh edhe punova me ditë e natë edhe... n'atë kohë Zastavë kemi pasë. Edhe e futa në gepek për me shku me dorëzu. Edhe m'ndalën te "Dragodani", te udhëkryqi aty. Qaty gjithmonë kanë nejtë asi policë të mëdhej. Beso u frigojsha kur i shifsha. Edhe m'ndalën. Edhe po m'pysin serbisht, normal ne kemi mësu në shkollë serbisht, po flasin serbisht, tha, "Ku po shkon?" Thashë, "Te nana". "Otvori gepek". "Çele gepekun". Kur e ka marrë tha, "Aa ti a n'fakultet po shkon a?" Edhe ma shkyvi projektin kështu, fletë për fletë.

Mandej kur shkova, e di që tu qajtë shkova te profesori dhe i thom, "Profesor, qeshtu qeshtu... ma kanë shky". E pa projektin e shkymë. Domethonë nuk, nuk o, a din, kur e din, kur e shef, e din një rrezik që e ke ruhesh pakëz, ke kujdes. Në atë kohë ka qenë, prapë po thom kohë pa kohë, në çdo hapë osht' deshtë.... Se tash tu folë po m'duket si andërr e keqe. Tash definitivisht, tash kur po flas, po tregoj për ato ditë, për ato, njëmend ka qenë kohë e keqe. E vështirë ka qenë. Atëhere ndoshta s'e kom përceptu në këtë mënyre, sepse nuk e kom ditë që osht' diçka ma mirë (kollitet), domethonë tash me krahasu më atë kohë, si nata me ditë osht' (buzëqeshë).

Jeta Rexha: Qysh folet, a e bisedon me shokët e shoqet, nëse jë hala n'kontakt ose me kolgët ose me njerëzit e tjerë, tash sot çka, qysh, qysh, a folet ma s'pari, qoftë në aspektin, në atë jetën, të them kushtimisht, publike edhe atë private? Pra kushtimisht për protestat...

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, jo Jeta, jo. Ndoshta shumë rrallë. Mas luftës e vërtetë osht' që kemi bisedu ma tepër. Kemi diskutu, kemi... Jo, me të tregu të drejtën jo. Ndoshta me kohë njerëzit veç e kanë tejkalu. Jonë zbehë kujtimet, jonë zbehë fotografitë e asaj kohe. Mirëpo, me të tregu t'drejtën kur

t'fillojmë unë me bashkëshortin tim me bisedu edhe flasim para fëmijëve, as fëmijët e mi s'kanë durim me m'dëgju. Domethonë, s'mujnë me kuptu edhe nuk mujnë me kuptu dallimin edhe me marrë me ju tregu për t'gjitha këto, besom që në të shumtën e rasteve nuk besojnë. Gjeneratat e reja jo. Na që jemi pak më të vjetër... rrallë bisedohet për këto gjana tash. Ndoshta pse jemi të angazhuar me puna, me probleme, me, si me mbijetu. Edhe jo, shumë rrallë. Edhe ma mirë, mendoj që osht' ma mirë, unë mendoj që osht' ma mirë.

Jeta Rexha: A ka barierrë për me bisedu apo del një pretekst që nuk, nuk ka nevojë me u bisedu ose...

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, definitivisht, definitivisht ka nevojë për me u bisedu edhe me u diskutu. Por ndoshta edhe njerëzit jonë pak të dëshprumë për shkak se noshta pas t'gjithë atyne viteve nëpër t'cilat kemi kalu t'gjithë, duke përfshi edhe prindërit e tu edhe prindërit e mi e t'gjithë. Ndoshta aspekti i lëvizjës së lirë, i disa predispozitave, prej disa përparsive që ju i keni tash. Prapë se prapë mendoj që në disa fusha osht' deshtë pak me u bo më shumë edhe njerëzit jonë t'irrituar, në atë aspektin a ja ka vle barra qiranë.

Jeta Rexha: Qashtu edhe mundët... edhe marshin e grave tash specifikisht meqë u organizu, e u drejtu, e u nisë prej grave, nëse veç edhe kur bisedohet për protestat e krejt atyne viteve, a tregohet që qekjo ka qenë me gra, qekjo ka qenë qishtu, qëllimi ka qenë me shku deri në Drenicë?

Albertina Ajeti-Binaku: Jo, jo. Definitivisht që jo...

Jeta Rexha: Domethonë vjen n'harresë ajo...

Albertina Ajeti-Binaku: Definitivisht vjen n'harresë. Edhe kur m'kontaktuat për me bisedu, ndoshta edhe osht' pak truri i njeriut, domethonë...

Jeta Rexha: Memorie selektive ndoshta?

Albertina Ajeti-Binaku: Po. Për me i, me i hekë, për me ju bo *delete* [Eng.: fshi] atyne gjanave të cilat s'ke dëshirë me i mbajtë. Edhe e vërtetë osht' që shpesh herë mundohna me i kujtu disa gjana, sidomos masi që ka fillu konflikti. Edhe ashtu mundohna me hy në kujtimet e mia, definitivisht jonë fshi. Kështu që, pak ka t'bëjë edhe me çështjen e brendshme emotive, por edhe me trurin. Këtë rast, timin. Por definitivisht shumë pak bisedohet për, për ato çka kanë ndodhë, pse jonë organizu, qëllimi. Mendoj që shumë njerëz të cilët n'atë kohë kanë bo, kanë organizu, kanë qenë t'fuqishme, kanë qenë...

Tash kur mendoj ato gra që kanë organizu, se une kom qenë veç pjesëmarrëse. Mirëpo, n'atë kohë me organizu asi lloj protestash, bajagi osht' deshtë me qenë trimëreshë. Po flas n'atë kohë Vera Pula, kjo Ahmeti, Sevdije Ahmeti. Kanë qenë do gra në atë kohë që tash, tash për me e kthy me i pa ato gra bajagi osht' deshtë me qenë trimëreshë edhe me qenë... sepse ke mujtë me përfundu e vdekur, e malltretuar, e burgosur edhe kërkush s'ka mujtë me t'ndihmu atë kohë. Kështu osht', osht' gjynah, osht' mëkat që harrohen. Edhe personazhet e asaj kohe, mirëpo edhe ngjarjet e asaj kohe. Po flas për shumë, e shumë, shumë njerëz të cilët e kanë marrë atë fuqinë, energjinë edhe kanë organizu edhe

protesta edhe marshe edhe t'gjitha. Tash nuk besoj që, ndoshta mos ta ekzagjëroj po ajo kohë me marrë iniciativën, me marrë udhëheqjen e diçkafit, çka që osht' ka qenë shumë kohë e vështirë. Kështu që, por definitivisht jonë lanë në harresë.

Jeta Rexha: Faleminderit shumë!